



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
BORDI I ADMINISTRIMIT

VENDIM

Nr. 25 Datë 02 /10/2023

MBI

**“MIRATIMIN E SHITESËS SË SHKALLËS SË VËSHIRËSISË SË PUNONJËSVE
MBËSHTETËS (PASTRIMI/SANITAR), NË UNIVERSITETIN E ARTEVE, PËR
VITIN KALENDARIK 2023”.**

Në zbatim të Nenit 3, Pika 3 dhe Nenit 49 e vijim ...të Ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Bordi i Administrimit, pasi shqyrtoi materialin dërguar nga Drejtori i Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në Uart, ku u paraqitën dokumenta mbështetëse për rritjen e vështirësisë së punonjësve mbështetës (sanitar/pastrimi), referuar VKM-së nr. 326, datë 31.05.2023 "Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike", lidhja nr. III “Kriteret e ndarjes së punëve sipas shkallës së vështirësisë dhe dëmshmërisë për shëndetin”, pika 9, gërma c, (9. “Për punë të vështira e të dëmshme për shëndetin, punonjësve u jepet shtesë mbi pagë, sipas shkallëve të vështirësisë e të dëmshmërisë”, e konkretisht: **Punonjësve të pastrimit/sanitar u shtohet dhe shkalla e tretë, gërma i) të cilët kryejnë punë në kushte veçanërisht të rrezikshme në lartësi mbi 2 metra,** pas diskutimeve dhe me votim të hapur,

VENDOSI:

- 1. Miratimin** e rritjes së shkallës së vështirësisë së punonjësve mbështetës (pastrues/sanitar), sipas tabelës së më poshtme:

STAFIT ADMINISTRATIV 2 I UNIVERSITETIT TË ARTEVE POZICIONET AKTUALE	NUMRI I PUNONJËSVE SIPAS POZICIONEVE TË PUNËS	ISHTE/ SHKALLA E VËSHIRËSISË	BËHET/ SHKALLA E VËSHIRËSISË
SANITAR /PUNËTOR PASTRIMI KLI	9 (nëntë)	1+2 = 6.000 LEKË	1+2+3 = 11.500 LEKË




2. Efektet financiare të këtij ndryshimi vështirësie, të bëhen duke filluar nga data 1 Prill 2023, referuar pikës 15, të VKM-së nr. 326, datë 31.05.2023 "Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike";
3. Ky vendim të publikohet në faqen zyrtare Uart.


Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT I UNIVERSITETIT TË ARTEVE


Lavdrim SAHITAJ (Kryetar)



Ergis SEFA (Anëtar)



Prof. Asoc. Dr. Sokol SARAÇI (Anëtar)



Prof. Besnik BISHA (Anëtar)



Jeton SHEHU (Anëtar)



Lorenc VANGJELI (Anëtar)



Vladimir LLAKAJ (Anëtar)





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE
REKTORATI

DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE SJIP-A
Nr 615/1 Prot

Datë 29/09/2023

RELACION

LËNDA: KËRKESË PËR MIRATIM TË SHKALLËS SË VËSHIRËSISË

BORDIT TË ADMINISTRIMIT TË UART
TË UNIVERSITETIT TË ARTEVE

Referuar VKM-së nr. 326, datë 31.05.2023 "Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike", lidhja nr. III "Kriteret e ndarjes së punëve sipas shkallës së vështirësisë dhe dëmshmërisë për shëndetin", pika 9, gërma c), si dhe shkresës së Departamentit të Administratës Publike dërguar Universitetit të Sporteve ku i referohemi edhe ne, me nr. 3531/1, datë 21.07.2023 "Përgjigje kërkesës për shtesa mbi pagë për punonjësit mbështetës", parashikohet,


9) "Për punë të vështira e të dëmshme për shëndetin, punonjësve u jepet shtesë mbi pagë, sipas shkallëve të vështirësisë e të dëmshmërisë", e konkretisht:

Punonjësve të pastrimit/sanitar u shtohet dhe shkalla e tretë, gërma i) të cilët kryejnë punë në kushte veçanërisht të rrezikshme në lartësi mbi 2 metra.

Nga sa më sipër dhe bazuar në zbatimin e këtij vendimi, dhe shkresës së Departamentit të Administratës Publike me nr. 3531/1, datë 21.07.2023 "Përgjigje kërkesës për shtesa mbi pagë për punonjësit mbështetës", kërkohet miratimin për përfitimin e shtesës mbi pagë sipas shkallës së tretë, në masën 5500 (pesëmijë e pesëqind) lekë në muaj për punonjësit mbështetës (patrimi/sanitar) të Universitetit të Arteve.

Uart ka gjithsej 9 punonjës pastrimi/sanitarë (sipas tabelës më poshtë)

Jemi në pritje të miratimit tuaj.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

	STAFIT ADMINISTRATIV 2 UNIVERSITETIT TË ARTEVE POZICIONET AKTUALE	NUMRI I PUNONJËSVE SIPAS POZICIONEVE TË PUNËS	SHKALLA E VËSHTRËSISË
1	PËRGJEGJËS SALLE KL. VIII	1	1+2 = 6.000 LEKË
2	SPECIALIST KL.VII	1	1+2 = 6.000 LEKË
3	LABORANT KL.VI	4	1+2 = 6.000 LEKË
4	TEKNIK I MESËM SPECIALITETEVE TË NDRYSHME KL.V	4	1+2 = 6.000 LEKË
4	TEKNIK I MESËM SPECIALITETEVE TË NDRYSHME KL.V ELEKTRICISTI	1	2+3 = 9.500 LEKË
5	MAGAZINIER KL.V	1	2+3 = 9.500 LEKË
6	PUNËTOR KL.III	2	1+2 = 6.000 LEKË
7	SANITAR PUN PASTR. KL I	9	1+2 = 6.000 LEKË

DREJTOR / DR.M B NJ

MSC. ELIA PLAKU

PËRGJEGJËS/SEKTORI JURIDIK

MSC. ADELA KUSURI



